



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhje të mbajtur më 10.03.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamdi (Sadik) Mehmetit, Fitnete (Rexhë) Gorçajt, Osman (Gjeladin) Limanit, Magribe (Shefki) Salihajt dhe Milaim (Abdyl) Kelmendit.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. P-71914059-01948-1, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të PSH - rrugë, nr. P- 71914059-01949-11, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të PSH - rrugë, me destinim ndërtim, sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01 nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale, nr. P-71914059-01801-11, Zona kadastrale, Prishtinë, në pronësi të Hamdi (Sadik) Mehmetit, me sip. 4m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 71914059-01801-13, ZK, Prishtinë, në pronësi të Osman (Gjeladin) Limanit, sip. 54m², pjesë e parcelës kadastrale nr. P-71914059-01801-15, ZK, Prishtinë, në pronësi të Magribe (Shefki) Salihajt, sip. 23m², pjesë e parcelës kadastrale nr. P-71914059-01801-17, ZK Prishtinë, në pronësi të Milaim (Abdyl) Kelmendit, sip. 34m², parcela kadastrale nr. P-71914075-00867-69, ZK Çagllavicë, në pronësi të Fitnete (Rexhë) Gorçajt, sip 190m², me destinim infrastrukturë rrugore, planifikuar sipas Planit rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01 nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë.
- III.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- IV.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.
- V.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbëhen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtorja e Urbanizmit, me Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore për këmbim, nr. 05, nr. 350/02-66996/20, dt. 26.10.2020, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e parcelave kadastrale, nr. 01948-1, me sipërfaqe prej 33m², ZK, Prishtinë, PSH – rrugë, nr. 01949-11, me sipërfaqe prej 227m², ZK, Prishtinë, në pronësi PSH - rrugë dhe pjesën e parcelës nr. 01801-11, me sipërfaqe prej 4 m², në pronësi të Hamdi (Sadik) Mehmetit, pjesën e parcelës, nr. 01801-13, me sipërfaqe prej 54 m², në pronësi të Osman (Gjeladin) Limanit, pjesën e parcelës nr. 01801-15, me sipërfaqe prej 23 m², në pronësi të Magribe (Shefki) Salihajt, pjesën e parcelës nr. 01801-17, me sipërfaqe prej 34 m², në pronësi të Milaim (Abdyl) Kelmendit, ZK, Prishtinë, parcela nr. 00867-69, me sipërfaqe prej 190 m², në pronësi të Fitnete (Rexhë) Gorçajt, ZK, Çagllavicë, e cila gjendet në kuadër të blloqeve urbane “C-1-5” dhe “C-1-6”, të tërësisë “C-1” të Planit rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013. Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013. Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, pasi Komuna nuk ka pronë të veten për implementimin e projekteve të lartcekura.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale, nr. 01948-1, nr.01949-11, nr. 01801-11, nr. 01801-13, nr. 01801-15, nr.01801-17 dhe nr.00867-69;
- Vendim për miratimin e planit rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01 nr. 35-186850, dt. 02.10.2013;
- Destinimi për parcelat kadastrale, nr. 01948-1, nr.01949-11, nr. 01801-11, nr. 01801-13, nr. 01801-15, nr. nr.01801-17 dhe nr.00867-69, ZK Prishtinë, nga Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm,
- Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-46047/21, më 11.03.2021

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

